



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-066

Prishtinë, më 2 gusht 2016, në orën 17:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C -301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 2 GUSHT 2016

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti dhe Fikrim Damka, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Glauk Konjufca dhe Myfera Shinik, si dhe deputetët Shaip Muja, Shpejtim Bulliqi dhe Nait Hasani.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Uran Ismaili dhe Avni Bytyçi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Sali Rexhepi dhe Shefki Shoshaj.

Nga Zyra e BE-së: Blerta Bejtullahu,

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati dhe

Nga KDI-ja: Albert Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite:

1. Përgatitjet për organizimin e debatit profesional-shkencor lidhur me Marrëveshjen për shënimin e kufirit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Malit të Zi.

Kryetari i njoftoi pjesëmarrësit e mbledhjes për përgatitjet që duhen bërë për organizimin e debatit profesional-shkencor lidhur me Marrëveshjen për shënimin e kufirit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Malit të Zi.

Ai tha se u janë dërguar ftesa shumicës së institucioneve, agjencive të pavarura, institucioneve përkatëse që mund të kenë ndonjë impakt që ndërlidhet me shënimin e kufirit me Republikën e Malit të Zi.

Gjithashtu, u është bërë njoftimi të gjithë deputetëve veç e veç, kushdo që dëshiron të marrë pjesë në këtë debat. Tema është e qartë, ka të bëjë me raportin që do të paraqesë Komisioni Shtetëror për shënimin e kufirit. Në pjesën tjetër të diskutimit, po aq kohë do të ketë edhe pjesa e deputetëve që nuk pajtohen me raportin e Komisionit Shtetëror për t'i paraqitur argumentet dhe faktet e veta.

Pas kësaj, do të kemi diskutues, të cilët do të flasin, si Presidenti i vendit, Kryeministri i Republikës së Kosovës, ambasadori i SHBA-së, i cili ka kërkuar ta ketë një fjalë dhe të tjerë që dëshirojnë të diskutojnë për këtë temë.

Pastaj, Kryetari hapi diskutimin.

Rreth përgatitjeve që duhen bërë për organizimin e debatit profesional-shkencor lidhur me Marrëveshjen për shënimin e kufirit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Malit të Zi diskutuan nënkryetarët e Kuvendit: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Aida Dërguti, Slobodan Petroviq, Fikrim Damka, kryetarët e grupeve parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Glauk Konjufca, si dhe deputetët: Shpejtim Bulliqi, Shaip Muja dhe Nait Hasani, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, Kryesia e Kuvendit nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Debati lidhur me Marrëveshjen për shënjimin e kufirit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Malit të Zi do të drejtohet nga paneli drejtues, në përbërje të kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit, si dhe nga tre deputetë iniciues të këtij debati, ndërsa atë do ta drejtojë nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

Rrjedha e debatit do të zhvillohet sipas këtij planifikimi kohor:

- Një fjalë hyrëse do ta paraqesë kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Kadri Veseli;
- Fjalimi i Presidentit të Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi, 10 minuta;
- Fjalimi i Kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Isa Mustafa, 10 minuta;
- Fjalimi i Ambasadorit të SHBA-së në Republikën e Kosovës, z. Greg Delawi (do ta marrë fjalën sipas kërkesës së tij, 10 minuta;
- Komisioni Shtetëror për shënjimin e kufirit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Malit të Zi do ta paraqesë raportin, deri dy (2) orë;
- Ekspertët e propozuar nga grupi i deputetëve iniciues të këtij debati do t'i paraqesin argumentet e tyre, deri dy (2) orë;
- Diskutim i hapur për pjesëmarrësit e ftuar në këtë debat nga 10 minuta, kryetarët e grupeve parlamentare nga 10 minuta, deputetët nga 5 minuta, ndërsa Komisioni Shtetëror për shënjimin dhe mirëmbajtjen e kufirit shtetëror u përgjigjet pyetjeve dhe komenteve të adresuara gjatë debatit;
- Paraqitja e konkluzioneve nga Komisioni Shtetëror për shënjimin dhe mirëmbajtjen e kufirit shtetëror 15 minuta dhe deputetët iniciues të këtij debati 15 minuta.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 19:10 minuta.

Kryetari i Kuvendit:

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale